ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K. Regj. e Mbeturinave Pastërtia SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KRMFe-26-4314-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja e rregullt e automjeteve të kompanisë dhe furnizimi me pjesë rezervë sipas nevojave të kompanisë KRM Pastërtia Sh.A. - Ferizaj**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MAGJISTRALJA: FERIZAJ – PRISHTINE , F.SH PRELEZ I JERLIVE
(Adresa)

Ferizaj *(Vendi)* **70000** *(Kodi postar)*

+383 45944289 *(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

RAGIP ZEJNA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info.amrgrup@gmail.com
(Adresa elektronike)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SH.P.K. DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT FERIZAJ

16.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Mirëmbajtja e rregullt e automjeteve të kompanisë dhe furnizimi me pjesë rezervë sipas nevojave të kompanisë KRM Pastërtia Sh.A. - Ferizaj**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 05.06.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 15.05.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së pas procesit të rivlerësimit është bërë në datën 14.10.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 19.10.2026 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.

AK e ka pranuar kërkesën tonë si pjesërisht të bazuar duke e kthyer lëndën në rivlerësim, për çka ka publikuar edhe një vendim me datë 22.10.2026.

Pas rivlerësimit për herën e dytë, AK ka publikuar vendimin për anulim të tenderit me datën 29.10.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së (anulim tenderi) dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 03.11.2026 iu kemi drejtuar AK-së me këtë Kërkesë për

Rishqyrtim.

AK me datë 05.11.2026 e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë, po i drejtohemi OSHP-së me këtë Ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët të poentuar.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [X]

Hapja e tenderëve është bërë në datën 15.07.2026. Në procesverbalin e hapjes së tenderëve nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [**X**] **Jo** [ ]

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 05.06.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 15.05.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së pas procesit të rivlerësimit është bërë në datën 14.10.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 19.10.2026 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.

AK e ka pranuar kërkesën tonë si pjesërisht të bazuar duke e kthyer lëndën në rivlerësim, për çka ka publikuar edhe një vendim me datë 22.10.2026.

Pas rivlerësimit për herën e dytë, AK ka publikuar vendimin për anulim të tenderit me

datën 29.10.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së (anulim tenderi) dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 03.11.2026 iu kemi drejtuar AK-së me këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 05.11.2026 e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë, po i drejtohemi OSHP-së me këtë Ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 4 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 4 të LPP-së me rastin anulimit të tenderi përkatësisht me rastin e eliminimit të tenderit tonë me arsyetimin e paraqitur tek Njoftimi mbi Vendimin e AK-së dhe tek Fleta standarde për eliminim e tenderuesve që na është dërguar. Arsyeja pse e themi këtë është sepse ne jemi eliminuar me një arsyetim të pabazuar dhe të palejuar për aplikim në rastet e tilla dhe se arsyetimi i tillë shihet se është mbështetur në dispozita

ligjore që realisht nuk janë të sakta për qëllimin e aplikimit. Këtë arsyetim e bënë të pabazuar veçanërisht fakti që Njoftimi mbi Vendimin e AK-së (formulari B58) që është publikuar pas rivlerësimit të dytë, nuk është i njëjtë me Njoftimi mbi Vendimin e AK-së (B58) që është bërë pas ri-vlerësimit të parë e madje nuk është i njëjtë as me vendimin e vlerësimit fillestar që ishte bërë. AK na ka eliminuar me arsyetimin se gjoja ne jemi palë pa interes me që nuk paskemi vazhduar herën e parë me ankimim edhe në OSHP. Edhe pse këtë nuk e arsyeton apo nuk e parasheh asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit, të njëjtën gjë nuk e kemi hasur as në praktikën e deritanishme të zhvillimeve në procedurat e prokurimit.
Jne konstatojmë se janë disa arsye bazë të besueshme dhe të faktueshme se pse ky vendim i AK-së konsiderohet i pabazuar. Për ti paraqitur ato, fillimisht po e pasqyrojmë arsyetimin e anulimit që AK na ka dërguar neve:

ARSYETIM *[Tenderi juaj është refuzuar]* për këto arsye :

Oferta Juaj është refuzuar si "Palë pa interes" pasiqë pas refuzimit të kërkesës suaj për rishqyrtim, Ju nuk keni shfrytëzuar të drejtën për ankesë në shkallën e dytë pranë OSHP-së (sipas udhëzimeve për ankesë, bazuar në nenin 109 të LPP-së si dhe Rregulloren 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik gjegjësisht nenin 63.3., citojmë: "Kundër çdo vendimin të Autoritetit Kontraktues, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar, nëse ka, mund të paraqesë, në çdo rast, një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së.

Fakti i parë pse ne mendojmë se ky arsyetim është i pabazuar është arsyeja se bazuar në nenin 4.1.26 të LPP-së, ne jemi tenderues dhe palë e interesit deri në vendimin përfundimtar të procedurës. Ja si e përshkruan këtë nenin në fjalë:

Neni 4
Përkufizimet

1.26. **Palë e interesuar** - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.

Në rastin konkret ne jemi tenderues me interes me që e kemi vazhduar validitetin e tenderit dhe se realisht ne po dëmtohemi nga vendimi i AK-së sidomos për faktin që tenderuesi i përzgjedhur është i papërgjegjshëm në shumë pika.

Fakti i dytë se ne jemi palë me interes është se vendimi i parë i AK-së ka qenë për anulim të tenderit është komplet i ndryshëm me vendimin e dytë, e posaçërisht është i ndryshëm edhe me vendimin e tretë që vet AK bie në kundërshtim me vet veten në vlerësimin e gjendjes, dokumenteve dhe dëshmive të njëjta. Në vendimin e parë të dy tenderuesit jemi eliminuar me arsyetimin kinse kemi bërë tejkalim të buxhetit gjë të cilën e kemi demantuar me fakte se ka qenë shkelje e nenit 54.15 i RRPP-001/2022, në vendimin e dytë ne jemi eliminuar për gjoja nuk jemi palë me interes ndërsa OE tjetër është shpallur fitues, kurse në vendimin e tretë prap ne eliminohemi si palë pa interes por me bazë tjetër ligjore nga hera paraprake ndërsa OE tjetër për gabime dhe mangësi në tenderin e tijë. Tre vendime komplet të ndryshme për dy tenderues me dokumente të njëjta. Kjo përpos që është jo profesionalizëm ekstrem, është dëshmi se AK po mundohet me çdo kusht të manipuloj për të dalur nga situata. Për papërgjegjshmërinë e OE konkurrent do ju njohim në pretendimet e radhës, ndërsa arsyetimi i AK-së në rastin tonë po shihet se është komplet i pabazuar.

Fakti i tretë se ne jemi palë e interesit e ka dëshmuar edhe vet AK kur pasi është lëshuar vendimi i OSHP-së, na ka kërkuar që ta vazhdojmë validitetin e tenderit dhe të sigurimit. Ja kërkesa e AK-së për zgjatje që na është dërguar neve:

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Kompania Regjionale e Mbeturinave/ Regional waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada

KRM "PASTËRTIA" SH.A .- FERIZAJ

Adresa: Fsh. Gërlicë, magjistralja Ferizaj-Shkup, tel. 0290/327-406, 0290/325-025

Kërkesë për zgjatjen e validitetit dhe sigurimit të ofertës

Të nderuar,

Për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rregullt e automjeteve të kompanisë dhe furnizimi me pjesë rezervë sipas nevojave të kompanisë KRM Pastërtia SH.A. – Ferizaj", me nr.prok. KRMFe-26-4314-2-1-1

Kërkojme nga ana juaj që deri me datën 09.10.2026, para orës 16:00, OE të interesuar të vazhdojn validitetin e ofertës për 60 ditë si dhe sigurimin e tenderit nga data e skadimit edhe për 90 ditë të tjera.

Me respekt
Zyra e Prokurimit-Ferizaj.

07.10.2026

Me që pas ankesës së konkurrentit, OSHP e ka urdhëruar për rivlerësim të tenderëve, shtrohet pyetja, cili do ishte vendimi i AK-së po që se OE që një here e ka shpallur fitues e tani kinse të papërgjegjshme me vetëm një vërejtje do dilte i papërgjegjshëm. Si do vepronte AK në rast se do ishte i detyruar të na shpallte neve fitues e ne do tërhiqeshim me arsyetimin se jemi palë pa interes? Sigurisht se AK do aplikonte ndaj neve nenin 99.2 të LPP-së me që nuk ka asnjë bazë ligjore e juridike që e lejon keqpërdorimin dhe mos shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë efikase dhe transparente me arsyetimin e AK-së që na ka eliminuar neve. Krejt kjo tregon se ne jemi palë me interes.

Fakti i katërt se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i pa bazuar është edhe ajo që e thotë nenin 108/A i LPP-së si dhe interpretimi Nr.11 i datës 22.11.2022 i KRPP-së.
Ja si e përshkruan neni 108/A i KRPP-së të drejtën tonë që të jemi palë me interes:

Neni 108/A
Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

Të njëjtën e sqaron shumë mirë edhe interpretimi i KRPP-së. Ja si duket ajo që e thotë interpretimi i KRPP-së:

Paragrafi 1 i nenit 108/A të LPP-së, përcakton:

"1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit".

Po ashtu, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 i nenit 59 të Rregullores për Prokurim Publik, përcaktojnë:

59.1 Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që pretendohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij pranë Autoritetit kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

Pra ne jemi palë e interesit sidomos për faktin që po të vlerësonte si duhet AK në vlerësimin e parë, ne do duhej të shpalleshim fitues me që tenderuesi konkurrent nuk është i përgjegjshëm. DMTH AK për fajin e vet tani mundohet të na paraqes neve si palë pa interes. Tani më që ne jemi akoma në garë pasi që kemi vazhduar validitetin e tenderit dhe atë të sigurimit (*me kërkesë të vet AK-së*) dhe me që tenderuesi i konkurrent është i papërgjegjshëm e veçanërisht kur dihet se arsyetimi për eliminim i tanishëm është komplet i ndryshëm me atë të vendimit të parë dhe të dytë, tregon qartë se ne jemi palë me interes dhe se vendimi i AK-së për na cilësuar neve palë pa interes është i pabazuar. Asnjë nga dispozitat ligjore nuk e thotë dhe nuk e përcakton se mos vazhdimi i ankimimit në OSHP pas përgjigjes së marrur nga AK në Kërkesë për Rishqyrtim të heqë të drejtën e të qenurit palë e interesit. Pra me që asnjë nga dispozitat ligjore nuk e mbështet, nuk e sqaron e as nuk rregullon çështjen që lidhet ngushtë me arsyetimin e AK-së për eliminim tonë, tregon se AK ka shkelur plotësisht nenin 4 të LPP-së duke na larguar nga konkurrenca e mëtutjeshme.

2. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur aspak rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe transparente. Këtë e themi veçanërisht kur shohim se me kohë janë përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga zyrtarët e AK-së, nga Autoriteti Kontraktues që zhvillon këtë aktivitetet të prokurimit i cili ka të bëjë me fondet dhe burimet publike por që për çudi vet AK dhe zyrtarët e sajë tani nuk po i përfillin ato. Krejt kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit **qysh në vlerësimin e parë**. Cilësimi i një tenderuesi herë të përgjegjshëm e herë të papërgjegjshëm me të njëjtat dëshmi dhe tentimi këmbëngulës në eliminimin tonë madje tre herë me arsyetime dhe mbështetje ligjore të ndryshme dhe të gabueshme tregon se AK nuk po e respekton aspak atë që

thonë neni 1 dhe 6 i LPP-së.
Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe marrë për bazë mënyrën se si kishte rrjedhur procedura që nga fillimi i aktivitetit në fjalë, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së duke mos administruar procedurën e prokurimit në përputhje me nenin 4, 7, 59, 69 dhe 108/A të LPP-së. Kjo tregon hapur se gjatë dy ri-vlerësimeve përkatësisht me rastin e mos trajtimit të si duhet të dëshmive të OE NTP AUTO BOSCH e posaçërisht me rastin e eliminimit tonë pa asnjë bazë ligjore, AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderëve dhe administrimit me procedurën e prokurimit na ka diskriminuar dhe dëmtuar tre herë në rastet e eliminimit tonë dhe atë pa plotësuar asnjë kusht ligjor për këtë qëllim. Ky nen është shkelur edhe në rastet kur AK kishte përzgjedhur si fitues një tenderues komplet të papërgjegjshëm e po ashtu në rastin konkret kur AK të njëjtit ia fsheh mangësitë e sidomos ato që janë të falsifikuara nga tenderuesi NTP AUTO BOSCH. Krejt kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur AK na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore duke dhënë arsyetim të pabazuar dhe në kundërshtim të plotë me nenin 4 të LPP-së si dhe kur qëllimisht dhe në kundërshtim me parimet e mirëfillta të prokurimit mundohet ta fsheh faktin që tenderuesi NTP AUTP BOSCH ka falsifikuar dokumente. Kjo sjellje dhe ky veprim i kundërligjshëm i AK-së, bie ndesh plotësisht me nenit 7 të LPP-së pasi që edhe pse ne jemi tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm, eliminohemi pa asnjë arsye të bazuar ndërsa tenderuesi tjetër edhe pse është i papërgjegjshëm, i PAPËRSHTATSHËM dhe me dëshmi të falsifikuara, AK ia fshehë shkeljet e tilla. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të prokurimit dhe të vlerësimit si dhe për mangësitë dhe dëshmitë e falsifikuara nga OE i konkurrent, do ju njohim në pretendimin në vazhdim.


4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç e parasheh neni në fjalë dhe njëkohësisht ka aplikua arsyetime të paligjshme për të na eliminuar neve nga konkurrenca. Kjo ka ndikuar negativisht në mos vlerësim real, në mos aplikim të mangësive ndaj tenderuesit konkurrent dhe mos krahasim të drejtë të tenderëve me kërkesat e dosjes së tenderit. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

> Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

E themi këtë sepse ashtu siç e sqaruam edhe tek pretendimi i kaluar shihet se AK na ka eliminuar me arsyetim plotësisht të pabazuar dhe absurd në aspektin e aplikimit të drejtë të ligjit dhe dispozitave të tijë mbi tenderuesit që janë palë e interesit. Arsyetimin e eliminimit tonë e kemi elaboruar tek **pretendimi 1** ku edhe kemi ofruar argumente e fakte se si i tillë është plotësisht i pabazuar (*referoju pretendimit nr. 1*) dhe njëherit përbënë edhe shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së. Ne e kemi njoftuar AK-në se kemi shumë vendime kur vet OSHP i ka trajtuar tenderuesit palë me interes si në rastin tonë edhe pse në kontestin e parë ata nuk kishin kontestuar vendimin e AK-së ose nuk kishin vazhduar me ankimim në OSHP. Nga krejt kjo që u tha dhe u sqarua më sipër, nuk kemi se si të mendojmë ndryshëm përveç se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së me rastin e eliminimit tonë si dhe se ne jemi palë me interes dhe tenderues plotësisht i përgjegjshëm.

AK ka shkelur nenin në fjalë edhe me rastin e vlerësimit dhe përcaktimit të mangësive tek tenderi i OE N.T.P. AUTO BOSCH pasi që i njëjti është plotësisht i papërgjegjshëm dhe në tenderin e tijë ka edhe shumë mangësi si dhe dëshmi të falsifikuara për dallim nga ato që ja ka potencuar AK-ja. **Ja mangësitë e tenderit në fjalë:**

Mangësia e parë: OE NTP AUTO BOSCH ka paraqitur një deklaratë nën betim e cila nuk është e plotësuar si duhet dhe se si e tillë nuk prodhon asnjë efekt juridik për qëllimin e sajë. Arsyeja pse e themi këtë është sepse tek rreshti parë nuk e ka plotësuar fare emrin e tenderuesit dhe kështu i bie se nuk dihet kush është deklaruar në këtë dokument dhe as nuk dihet se për kë procedurë është dorëzuar kjo deklaratë. Ja si duket kjo deklaratë:



Aneksi 2. **DEKLARATA NËN BETIM**

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [redacted] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	NTP"AUTO BOSCH
Adresa e plotë:	FERIZAJ
I përfaqësuar nga:	
Emri	REXHEP FERIZI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	15.07.2026
Vula	N.T.P AUTO BOSCH

Me që deklarata në fjalë nuk është plotësuar si duhet dhe me që nga OSHP kemi shumë vendime të ngjashme që i sanksionojnë OE-të duke i cilësuar si të papërgjegjshëm për këtë lloj mangësie, konsideroj se AK është dashur të ia potencoj edhe këtë mangësi tek arsyetimi për eliminimin e tijë duke e cilësuar si tenderues të papërshtatshëm dhe të papërgjegjshëm.

Mangësia e dytë: OE NTP AUTO BOSCH kas paraqitur një autorizim nga kompania turke OTO HAKAN OTOMOTIV por që i njëjti nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit pasi që i njëjti nuk posedon emrin dhe numrin e procedurës së prokurimit për të cilën është dorëzuar. Ja si duket kërkesa e dosjes së tenderit:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë autorizimin nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit për shitje në Republikën e Kosovës për artikujt e kërkuar sipas specifikimeve teknike (Aneksi 1).	**Si dëshmi - OE duhet të ofrojë autorizimin nga prodhuesi apo distributori i autorizuar për shitje në Republikën e Kosovës (Autorizimi duhet te jete me titull te projektit dhe numër te prokurimi).**

Si përgjigje ndaj kësaj kërkese, ky OE ka dorëzuar autorizimin i cili duket kështu:

"yedek parçada lider"
otohakan®
otomotiv yedek parça

OTO HAKAN OTOMOTİV SANAYİ ve TİCARET LTD. ŞTİ.

17.04.2023

AUTHORIZATION

Here we OTO HAKAN OTOMOTİV, Authorize

The Partner:

N.T.P "AUTO BOSCH"

Address: Ferizaj-Kosove.

Certifikate of Registration No, 80462204
Fiscal No. 600214051

Represented by: Rexhep Ferizi-Manager of the Company

To apply to all public tenders to sumbit a bid and subsequently negotiate and sign related Contract in the territory of Republic of Kosova regarding auto spare parts.

We and our partner will be responsible for implementation of full warranty in the Territory of Republic of Kosova.

With this letter we Authorize N.T.P " Auto bosch" from Ferizaj Republic of Kosova to sell our products for trucks of Mitsubishi, Isuzu, Hyundal and Nissan and we offer a guarantee of 1 (one) year for every sale where durning this 1 year servicing and maintenance will be done by the authorized service

This Authorization cover and supply all of the spare parts that belong of our products.

OTO HAKAN OTOMOTİV

N.T.P."AUTO BOSCH"

AUTO BOSCH
FERIZAJ

Maltepe Mah. Davutpaşa Cad., Beyaz Park 2. Etap Sit. A Blok No.34AE, Zeytinburnu/İST.
Tel.: (212) 481 00 60 (pbx) www.otohakan.com • bilgi@otohakan.com
Fax: (212) 483 26 48 otohakanotomotiv otohakanotomotiv otohakan

Po shihet pra që i njëjti autorizim nuk e posedon fare emrin e tenderit dhe numrin e prokurimit siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit por i njëjti posedon edhe datën 17.04.2023 që tregon se është lëshuar shumë vite më parë se sa të iniciohej procedura e

prokurimit në fjalë. Nisur nga dyshimet rreth datës dhe nisur nga fakti që ky autorizim nuk e posedon emrin e tenderit e as numrin e tenderit, ne kemi pasur dilema rreth vërtetësisë së tijë andaj për verifikim iu kemi drejtuar kompanisë OTO HAKAN OTOMOTIV me kërkesën për të sqaruar autorizimin e tillë. Pyetja jonë dhe përgjigja e kompanisë rreth vlefshmërisë së këtij autorizimi si e shkëputur nga e-maili i plotë që e gjeni edhe të bashkangjitur, duket kështu:

> Is the economic operator in question still authorized by your company to represent you, or to sell and supply spare parts?
>
> No, the company in question has no connection or commercial dealings with us. They do not represent us, and they have not purchased any parts from us.

Bazuar në këtë dhe në tërë atë që ka thënë kompania OTO HAKAN OTOMOTIV rreth autorizimit të tillë, del që ky autorizim nuk është valid dhe në mes tyre nuk ka pasur asnjë here ndonjë bashkëpunim apo furnizim/transaksion me pjesë këmbimi për asnjë lloj të pjesëve. Më detalisht, këtë e-mail si të plotë e gjeni të bashkangjitur pas kësaj kërkese për rishqyrtim.
Marrë për bazë formën jo të rregullt të autorizimit që nuk i përgjigjet kërkesës së dosjes së tenderit dhe marrë për bazë edhe përgjigjen nga kompania autorizuese rreth vlefshmërisë së këtij autorizimi, del që autorizimi në fjalë është i pa vlefshëm dhe kjo e bënë tenderuesin plotësisht të papërgjegjshëm.

Mangësia e tretë OE NTP AUTO BOSCH kas paraqitur një ISO certifikatë të kompanisë OTO HAKAN OTOMOTIV por që e njëjta nuk është dokument i vlefshëm dhe i besueshëm. Fillimisht shihet se në dosjen e tenderit është kërkuar që ISO certifikata të jetë nga prodhuesi i pjesëve ndërsa ISO certifikata e paraqitur nuk është e tillë pasi që kompania OTO HAKAN OTOMOTIV nuk është prodhuese e pjesëve por vetëm tregtuese e tyre. Përpos kësaj kjo certifikatë shihet se është e manipuluar tek emri i kompanisë tek adresa e sajë dhe tek data e vlefshmërisë së sajë. Për të ju bindur me këtë, po ua paraqesim në mënyrë vizuale:



CERTIFICATE

TÜV SÜD

Management system as per
EN ISO 9001:2015

In accordance with TÜV TÜRKİYE procedures, it is hereby certified that

otohakan
otomotiv yedek parça

OTO HAKAN OTOMOTİV SAN. VE TİC A.Ş.

Kerimbey Mahallesi 1705.Cadde No:11/2
TR-55300 Tekkeköy

applies a management system in line with the above standard for the following scope

Design, production, marketing, sales, process of import and export of spare parts for automotive sector

Certificate Registration No. 20100141401033

Valid until: 2027-21-10
Initial certification: 2014-11-11

Certification Body
at TÜV Turkey

This certification was conducted in accordance with TÜV TÜRKİYE auditing and certification procedures and is subject to regular surveillance audits.

TÜRK

IAF

Bazuar në këtë po shihet se emri i kompanisë është i falsifikuar dhe vërehet tek madhësia dhe lloji i shkronjave, adresa e kompanisë nuk është reale, e po ashtu edhe data e kompanisë është e ndryshuar sepse nuk ka asnjë ISO CERTIFIKATË që lëshohet me validitet 16 vite. Pra dokumenti në fjalë shihet se është i falsifikuar për çka kërkojmë që përveç se duhet cilësuar tenderuesi i papërgjegjshëm, ndaj të njëjtit duhet të merren edhe masat ndëshkuese sipas nenit 99.2 të LPP-së duke e futur në listën e zezë dhe duke e detyruar AK-në për konfiskim të sigurimit të tenderit.
Për tu siguruar se certifikata e tillë nuk është reale, ne ju kemi drejtuar kompanisë OTO HAKAN OTOMOTIV me kërkesë për sqarim dhe verifikimin e sajë. Kompania në fjalë ka deklaruar se kjo certifikatë nuk u përket atyre dhe se **si dëshmi është e falsifikuar**. Ja si ishte pyetja jonë dhe përgjigja e tyre rreth kësaj certifikate si e shkëputur nga e-maili që di të plotë e gjeni të bashkangjitur pas kësaj kërkese për rishqyrtim.

ISO 9001:2015 Certificate: Is the attached certificate an authentic and valid document pertaining to your company's quality management system?

The document you sent is a forgery, created by third parties using our company name. I have attached our company's genuine ISO certificate.

Our company has no affiliation whatsoever with the firm in question. In 2023, they requested authorization as a prerequisite for conducting business, but once they obtained the relevant documentation, they disappeared. We have never engaged in any commercial dealings or transactions with them.

Thank you,
Have a good day.

H.HAKAN MERMER

Pra po shihet se kjo certifikatë është cilësuar **si e pavlefshme dhe e falsifikuar** edhe nga vet kompania OTO HAKAN OTOMOTIV andaj përpos që tenderuesi në fjalë duhet të shpallet i papërgjegjshëm, i njëjti duhet të shpallet edhe i papërshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Ne kërkojmë gjithashtu që ndaj kësaj kompanie të merren edhe masa disiplinore mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së duke e futur në listën e zezë, duke e detyruar AK-në për konfiskim të sigurimit të tenderit dhe duke e paraqitur ë prokurori për falsifikim të dëshmive. Për të ju bindur edhe më shumë se ISO certifikata e tillë është e falsifikuar, në attach po u paraqesim ISO certifikatën aktuale të OTO HAKAN OTOMOTIV të cilën na e ka dërguar pas kërkesës për verifikim.

Mangësia e katërt: OE NTP AUTO BOSCH ka paraqitur edhe disa katalogje për pjesët e ofertuara por që katalogjet e tilla duken të jenë të pavlefshme dhe komplet të formuara nga vet tenderuesi. Ne dyshojmë se asnjë nga katalogjet nuk është i rregullt por veçanërisht jemi të sigurte se katalogu i tipit të pjesëve ISUZU nuk është i vërtetë. Po që se shikohet me vëmendje, asnjë nga pjesët e paraqitura nuk përputhem me pjesët rezervë reale të tipit ISUZU. Mjafton të kërkosh në internet në faqe zyrtare të ISUZU dhe do bindeni edhe vet. Përpos kësaj nga këto katalogje, askund nuk dihet se kush është prodhues real i tyre. Dëshmitë e tjera të kërkuara nga prodhuesit janë të ndryshme me emrat e prodhuesve të pjesëve që figurojnë nëpër këto katalogje të cilat shihen se i ka krijuar vet tenderuesi andaj katalogjet e tilla e veçanërisht ai i tipit ISUZU nuk janë real dhe nuk e plotësojnë kushtin për tu cilësuar të pranueshëm. Mos dorëzimi i katalogjeve reale nga prodhuesi dhe mos dorëzimi i katalogjeve me pjesë të sakta që AK kishte kërkuar, e bëjnë tenderuesin komplet të papërgjegjshëm. Ne kërkojmë nga OSHP sqarim të këtyre katalogjeve sepse këto katalogje janë të pa sakta dhe se AK qëllimisht po i pranon edhe pse e din që janë të manipuluara dhe jo reale.

Mangësia e pestë: OE NTP AUTO BOSCH ka paraqitur disa referenca por nga pamja e tyre duket se jo të gjitha janë reale dhe të vërteta. Këtu kisha me cek referencën e datës 10.06.2025 e lëshuar nga NPL Përparimi SH.A. e cila duket qartë se është e manipuluar tek pjesa e nënshkrimit të lëshuesit të sajë. Këtë mundeni ta vëreni nëse e shikoni me kujdesë dhe e krahasoni me referencën e datës 04.02.2025 e lëshuar nga po i njëjti person. Shtrohet pyetja si është e mundur të nënshkruhen dhe vulosen krejtësisht në mënyrë identike dy dokumente të ndryshme që datojnë në periudha të ndryshme kohore. Nisur nga kjo, dyshojmë se referenca në fjalë është e manipuluar andaj kërkojmë nga OSHP që të bëhet verifikim ligjor i sajë. Pa referencën e tillë tenderuesi në fjalë nuk e plotëson kriterin e kërkuar nga dosja e tenderit andaj edhe do duhej të i potencohej si mangësi.

Nisur nga të gjitha që i thamë më sipër dhe nisur edhe nga gjendja reale në tenderit e OE fitues, përfshi edhe sqarimet e dorëzuara pas kërkesës së paligjshme të AK-së, del që

tenderuesi NTP AUTO BOSCH është plotësisht i papërgjegjshëm dhe se posedon më shumë mangësi se sa ato që ja ka potencua AK-ja.

Bazuar në krejt këtë, del që AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së me rastin e ri vlerësimit të tenderëve, me rastin e eliminimit tonë si dhe me rastin e mos potencimit të të gjitha mangësive ndaj OE NTP AUTO BOSCH. Po që se AK do vlerësonte tenderët ashtu si duhet, qysh herën e parë AK do duhej që si fitues të na shpallte neve me që jemi tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm në këtë proces të prokurimit.

5. AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022 me rastin e anulimit të tenderit dhe shkelja e tillë vjen si pasojë e mos respektimit të nenit 1, 4, 6, 7, 59, 69, dhe 72 të LPP-së që AK nuk i ka respektuar fare gjatë vlerësimit. Po që se do respektoheshin si duhet kriteret e dosjes së tenderit dhe vlerësimi do bëhej në përputhje me nenet e cekura më lartë, AK do kishte një OE që i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderit kështu që nuk do ishte fare e nevojshme për ta anuluar tenderin. Pas analizimit dhe verifikimit të ofertës tonë dhe krahasimin e sajë me atë që ishte kërkuar AK në dosjen e tenderit por edhe me atë që AK ka theksuar kur na ka eliminuar si të papërgjegjshëm, del që tenderi jonë i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga AK dhe është plotësisht palë me interes. Me që u sqarua edhe çështja e të qenurit palë me interes, dhe me që krejt kjo ka ardhur për fajin e vet AK-së që nuk ka vlersuar si duhet qyshe herën e parë, tregon edhe më shumë se AK po aplikon anulimin e tenderit në mënyrë të paligjshme dhe të panevojshme vetëm për ti ikur detyrimit që ne të jemi fitues të tenderit.

Nisur nga kjo që u tha më lartë, lirisht mund të konstatohet se aplikimi i anulimit të tenderit është duke u bërë në kundërshtim me realitetin që mbretëron tek komplet procedura në fjalë.

Anulimi i tenderit që AK e ka publikuar duket kështu:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **"Mirëmbajtja e rregullt e automjeteve të kompanisë dhe furnizimi me pjesë rezervë sipas nevojave të kompanisë KRM Pastërtia Sh.A. - Ferizaj"**

Numri i aktivitetit te prokurimit: **KRMFe-26-4314-2-1-1**

Nr.	*Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik*	*Cmimi total i ofertes i peshuar*
1.	NTP,, Auto Bosch " Ferizaj	272,489.66 €
2.	" DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT " SH.P.K. Ferizaj	791,278.22 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj- Zyra e Prokurimit ANULON procedurën e prokurimit!

Ky arsyetim nuk posedon fare bazën ligjore mbi të cilën është anuluar dhe realisht nuk përputhet me asnjë nga mundësitë që i ofron neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i RRPP-001/2022 për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Duhet ceket edhe kjo se asnjeri nga Legjislacioni Primar / as Sekondar që ishte në fuqi kur ka filluar procesi i prokurimit e që duhet aplikohet deri në mbyllje të këtij aktiviteti nuk ofron mundësi të anulimit të tenderit

pa asnjë arsyetim sepse qartë shihet nga tenderi jonë që AK e ka një tenderues komplet të përgjegjshëm.

Ja si duken mundësitë që i ofron LPP dhe RRPP-001/2022 për ndërprerje të aktivitetit të prokurimit pas hapjes publike:

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Ndërsa sipas RRPP-001/2022 përkatësisht nenit 43, mundësitë për anulim duken kështu e që sipas anulimit shihet se AK e ka keq aplikuar dispozitën nr. 43.7 të RRPP-001/2022:

43.5 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

43.7 Procedura e prokurimit ***pas hapjes së ofertave*** **mund** të anulohet për arsyen e mëposhtme:

a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Arsyetimi i AK-së se gjoja ne nuk jemi palë me interes nuk qëndron sepse nga sqarimi detal i arsyes së eliminimit u kuptua se edhe vet AK e ka arsyetuar se ne jemi palë me

interes dhe se faji për këtë gjendje është tek gabimi i vet AK-së që herën e parë ka vlerësuar gabim.

Nisur nga kjo nuk kemi se si të mendojmë ndryshe për veç asaj që AK po shkelë plotësisht nenin 62 të LPP dhe nenin 43 të RRPP-001/2022 me rastin e anulimit të këtij tenderi.

6. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar si duhet kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat veta sipas nenit 69.2 dhe 69.4 të LPP-së. AK ka vendosur vet kërkesa teknike që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që gjatë vlerësimit nuk i ka zbatuar si duhet. Kërkesat për përshtatshmërinë teknike si dhe për përshtatshmërinë profesionale që janë kërkuar nga vet AK shihet se janë keq aplikuar dhe anashkaluar plotësisht kur e ka vlersuar tenderin e OE që më pas pa asnjë të drejtë ligjore dëshmitë e tilla ja ka pranuar si të rregullta. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kritereve të dosjes, aneksit 1 dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së të përcaktuara tek kërkesat e FDT-së dhe tek specifikim teknik, kemi të bëjmë edhe me favorizim të një OE të papërgjegjshëm dhe me fshehje të dëshmive të falsifikuar edhe pse ua kemi vërtetuar si të tilla.
Bazuar në këtë nuk kemi se si të mendojmë ndryshe për pos asaj që AK po shkelë nenin 69 të LPP-së dhe me këtë veprim po na e mohon kundërligjshëm të drejtën për marrjen e kontratës në fjalë.

7. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që gjatë ri vlerësimit të tenderëve ka kërkuar sqarime dhe ka lejuar plotësimin e dosjes së tenderit me dëshmi që nuk e lejon ligji përkatësisht neni 72 i LPP-së. Këtu shihet qartë mos aplikimi i drejtë nenit 72 të LPP-s ku OE që e ka shpallur fitues shihet se i ka pranuar dëshmi të cilat realisht nuk mund të sqarohen. Për çudi këtij tenderuesi i është lejuar plotësimi i dosjes së tenderit disa herë por edhe përkundër kësaj i njëjti nuk ka arritur të ofroj dëshmi bindëse, reale dhe të vërteta andaj si i tillë konsiderohet plotësisht i papërgjegjshëm. Dëshmitë si autorizim i prodhuesit nuk munden të sqarohen. Po ashtu as dëshmitë si referenca, katalogu, ISO certifikata etj nuk munden të pranohen si dëshmi të reja por vetëm munden të kërkohet sqarime rreth tyre. Pra lejimi i plotësimit të dosjes së tenderit me kaq shumë dëshmi dhe pranimi i sqarimeve me dëshmi shtesë që nuk ishin në tenderin e këtij OE, konsiderohet favorizim i hapur dhe shkelje e plotë e nenit 72 të LPP-së.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që u thanë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar **ankesa** e **OE** "**DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT"** lidhur me tenderin "**Mirëmbajtja e rregullt e automjeteve të kompanisë dhe furnizimi me pjesë rezervë sipas nevojave të kompanisë KRM Pastërtia Sh.A. - Ferizaj**" i iniciuar nga **K. Regj. e Mbeturinave Pastërtia SH.A..**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **K. Regj. e Mbeturinave Pastërtia SH.A.**, dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, vetëm në kërkesat e dosjes së tenderit dhe ato të specifikimit teknik**,** e që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej **OE** "**DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT".**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mosdhënia e mundësisë për tenderim, rrezikon të na shkaktoj dëme materiale për vlerën e fitimit te munguar dhe shpenzimet e përgatitjes se tenderit njëkohësisht do të bëjë dëmtimin e reputacionit si njëra ndër kompanitë më të njohura për shitjen e këtyre artikujve. Vetëm demet/kostoja e kontestimit të vendimit të AK-së deri tani kanë arritur vlerën 4,200.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 Njoftim per Kontrat
- 2 Template per Dosja e Tenderit
- 3 Paramasa (2 faqe) -Mirembajtja Automjeteve
- 4 Procesverbali i hapjes
- 5 Njoftim mbni vendimin e AK - Ri vleres-mi 14.10.2026
- 6 KERKESE PER RISHQYRTIM 19.10.2026 - DC&E SHPK
- 7 Vendim për rishqyrtim te kerkeses Dielli - 22.10.26
- 8 Kerkese per pergjigje ne secilin pretendim te Kerkeses per Rishqyrtim - 26.10.2026
- 9 Njoftimi mbi Vendimin e AK - 29.10.2026 ANULIM
- 10 Deklarata nen Betim - e AUTO BOSCH
- 11 Vertetimi i ATK dhe marreveshja per Borgjet - e AUTO BOSCH
- 12 Autorizimi -Otohokan XXXXX - e AUTO BOSCH
- 13 Përgjigjeje ne kërkesën për sqarimin e tenderit-ISO_12.10.2026 - e AUTO BOSCH
- 14 Referenca e dyshimte - e AUTO BOSCH
- 15 Konfirmimi nga OTO HAKAN OTOMOTIV PER Autorizim dhe ISO
- 16 KERKESE PER RISHQYRTIM 03.11.2026 DC&E SHPK
- 17 Vendimi per rishqyrtim DIELLI 05.11.2026
- ISO 9001-2015 OTO HAKAN OTOMOTIV

***Vërejtje:* Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet e gjeni të bashkangjitur ndërsa materialin e të gjithë tenderuesve e gjeni në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në AK.**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*